



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.  
\_\_\_\_\_.2022

Tiranë, më

**VENDIM**

**Nr. 68, datë 23.02.2022**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM  
GRADIMI, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatori z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
    - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
    - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
  2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nëntregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përktthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, të cilët do të përcaktojnë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë, edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e çështjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ai identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsytet e zgjidhjes së çështjes (shih*

dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2 e 3). Në çështjet penale, i kushton rendësi të gjithë elementeve të veprës penale (shih dosjen 4) e ka njohuri edhe për vleftësimin e arrestit në flagrancë e caktimin e masave të sigurimit (shih dosjen 5). Ka njohuri të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Natyra e çështjeve që ai ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të tij të përftuara përmes përvojës në punë. 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë njohuri të tij lidhur me çështjet e anulimit të veprimeve përmbartimore (shih dokumentin 1), për lirimin e dorëzimin e pronës (shih dokumentin 2), për pagimin e dëmit pasuror e jopasuror (shih dokumentin 3 e dosjen 1), për njohjen pronar (shih dosjen 2), për zgjidhjen e martesës (shih dosjen 3), për përgjegjësinë penale për veprën penale të "Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt" të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (shih dosjen 4) dhe mbi vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masave të sigurimit personal (shih dosjen 5)".

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

***- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në vendimet civile, evidentohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

Gjithashtu, edhe në vendimet penale, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli apo kërkesa penale*), evidentohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur, duke përshkruar faktin penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Rrethanat e faktit vijnë menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsyetimit lidhur me kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.<sup>1</sup>

***- Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orienton më pas ndërtimin e një strukture specifike në organizimin e arsyetimit të vendimeve, në çështje me natyra të ndryshme (penale themeli, kërkesa

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 1828 (283), datë 20.04.2016 dhe nr. 62-2014-2783 (464), datë 22.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

penale, çështje familjare, çështje administrative, çështje civile të përgjithshme dhe çështje marrëdhënie pune).

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtari krijon idenë e tij rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative, familjare apo penale.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar qartë dhe saktë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dispozitat e ligjit procedural dhe të ligjit material në gjithë përmbajtjen e vendimit, në vendin e duhur dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*shfuqizim akti administrativ, marrëdhënie pune, padi pronësie, padi detyrimi, , pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kundërshtim veprimi përmbarimor, zgjidhje martese etj*), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, të Kodit të Punës, të Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

- a) Në vendimin gjyqësor me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv, gjyqtari identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (*nenin 510 të K.Pr.Civile*) në lidhje me përcaktimin e saktë se çfarë do të kuptohet me titull ekzekutiv, si dhe kushtet e vlefshmërisë së tij, (*nenin 609 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv;<sup>2</sup>
- b) Në vendimin gjyqësor me objekt padinë reale të kërimit të sendit (*padia e rivendikimit*), gjyqtari, duke marrë fillimisht në analizë padinë, identifikon dispozitën ligjore relevante, nenin 296 të K.Civil, në lidhje me kërkimin kryesor të padisë, kërkimin e sendit, si dhe nenin 298 të K.Civil, në lidhje me kërkimin aksesor të padisë, kthimin e të ardhurave të sendit;<sup>3</sup>
- c) Lidhur me padinë e detyrimit kontraktor dhe pagimin e kamatave ligjore, gjyqtari identifikon nenet 690, 450 dhe 481 të Kodit Civil lidhur me detyrimet kontraktore, mospërbushjen e tyre, fuqinë detyruese të kontratës, shpërblimin e dëmit të rrjedhur nga vonesa e pagesës, kur debitori quhet me vonesë;<sup>4</sup>
- d) Në vendimin gjyqësor me objekt marrëdhënie pune, me qëllim përcaktimin se ndryshimi i pozicionit të punës do të konsiderohet ndryshim i kontratës së punës dhe jo zgjidhje e saj, gjyqtari identifikon dispozitat materiale relevante (*nenet 12 dhe 21 të*

<sup>2</sup> Vendimi nr. 62-2016-2572 (669), datë 01.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>3</sup> Vendimi nr. 62-2015-4981 (1480), datë 13.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 62-2015-213 (81), datë 22.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

*K.Punës*), me qëllim identifikimin e elementëve të kontratës së punës, për të konkluduar se pala paditëse ka zgjedhur një shkak ligjor të gabuar;<sup>5</sup>

- e) Në vendimin gjyqësor me objekt padi detyrimi, me qëllim përcaktimin e natyrës së kontratës në fjalë, si dhe të konkludimit në lidhje me kërkimet në padi, gjyqtari identifikon normat ligjore relevante (*nenet 732, 450, 480, 732 të K.Civil*);<sup>6</sup>
- f) Në vendimet gjyqësore me objekt zgjidhje martesë dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj, gjyqtari identifikon dispozitat materiale relevante (*nenet 132, 192, 197, 210, 146 dhe 143 të K.Familjes*) etj.<sup>7</sup>
- g) Në vendimin për pezullimin e gjykimit, lidhur me padinë me objekt shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, gjyqtari ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në themelin e saj, nëse më parë nuk vendoste Gjykata Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e përmbajtjes së shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimet e detyrueshme në sektorin e transportit”, i ndryshuar, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore përcakton limitet e vlerës së dëmshpërblimit jopasuror. Sipas tij, nga ana tjetër, kjo dispozitë ligjore vjen në kundërshtim me nenet 4/1, 17, 18 dhe 41 të Kushtetutës. Në lidhje me sa parashtrohet më sipër, gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm nr. 10076/2009 për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, si dhe dispozitat kushtetuese, në lidhje me kushtetutshmërinë e dispozitës të ligjit të sipërcituar;<sup>8</sup>
- h) Në vendimin për pezullimin e gjykimit, lidhur me padinë me objekt padie “*lirim dhe dorëzim sendi*” dhe me objekt kundërpadie “*njohje pronar me parashkrim fitues*”, gjyqtari ka vlerësuar se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfitojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së nenit 168/1 të K.Civil, në kushtet kur kjo dispozitë nuk parashikon fitimin e pronësisë me parashkrim bazuar në një titull të ndryshëm nga veprimi juridik. Sipas gjyqtarit, kjo dispozitë ligjore në mënyrën se si është hartuar, cenon një nga të drejtat më themelore, siç është e drejta e pronës, duke ardhur në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës, me nenin 14 të KEDNJ dhe me jurisprudencën e GJEDNJ. Në lidhje me sa parashtrohet më sipër, gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, nenin 168 të Kodit Civil, i cili normon parashkrimin fitues me titull, si dhe dispozitat kushtetuese dhe të KEDNJ, në lidhje me kushtetutshmërinë e kësaj dispozite;<sup>9</sup>
- i) Në vendimin për pezullimin e gjykimit, lidhur me padinë me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, gjyqtari ka vlerësuar se çështja nuk mund të zgjidhej në themelin e saj, nëse më parë nuk vendoste Gjykata Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e fjalisë së dytë të paragrafit të pestë të nenit 610 të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin nr.122/2013, datë 18.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.2016, Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, në kushtet kur kjo fjali e shtuar vjen në kundërshtim me nenet 4, 17, 41 dhe 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, duke cenuar kriteret e kufizimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo sjell cenimin e të drejtës së pronësisë, si dhe nga ana tjetër, ligji nr.122/2013, datë 18.04.2014, është miratuar në kundërshtim

<sup>5</sup> Vendimi nr. 62-2015-651 (267), datë 24.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 62-2014-1191 (471), datë 14.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>7</sup> Vendimi nr. 62-2016-522 (134), datë 03.02.2016 dhe vendimi nr. 1569 (410), datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

<sup>8</sup> Vendimi nr. 13, datë 22.06.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

<sup>9</sup> Vendimi nr.9, datë 15.03.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

me elementët e procesit të rregull ligjor legjislativ, duke cenuar parimin e shtetit të së drejtës. Në lidhje me sa parashtrahet më sipër, gjyqtari identifikon ligjin e zbatueshëm, nenin 610 të K.Pr.Civile, si e vetmja dispozitë që trajton padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore, në përmbajtje të së cilës disiplinohet edhe procedura e pezullimit të ekzekutimit, në rastet kur është ngritur padi për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, si dhe dispozitat kushtetuese, në lidhje me kushtetutshmërinë e paragrafit të pestë, të shtuar në dispozitën ligjore të sipërcituar.<sup>10</sup>

(ii) Në vendimet penale të analizuara, gjyqtari identifikon dispozitën materiale penale të sanksionuar në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, në rastet kur kemi të bëjmë me vendime themeli, ndërsa në një rast tjetër, ku kemi të bëjmë me kërkesa penale, gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizimit të çështjes dhe të konkludimit në lidhje me bazueshmërinë në prova dhe në ligj, nga ku evidentohet më konkretisht se: Në vendimet penale të themelit, gjyqtari identifikon nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe nenet 134/2 në lidhje me akuzën “Vjedhja”, më shumë se një herë. Referohet dispozita e Kodit Penal, e pjesës së posaçme, në lidhje me veprën penale për të cilën procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit, ekzistencën e rrethanave rënduese, revokimin e vendimit të pezullimit me vënie në provë dhe bashkimin e dënimeve (*nenet 47, 50, 58, 62/1 dhe 56/2 të K.Penal*).

Në kërkesën penale me objekt “vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, gjyqtari identifikon dispozitën përkatëse relevante (*nenin 290/2 të K.Penal*).

Sa i përket ligjit procedural civil, gjyqtari ka referuar dhe cituar, si pjesë e arsyetimit të vendimit: nenin 185 të K.Pr.Civile, lidhur me shtimin e objektit të padisë;<sup>11</sup> nenet 189 dhe 190 të K.Pr.Civile, lidhur me ndërhyrjen kryesore;<sup>12</sup> nenet 55 dhe 160 të K.Pr.Civile, në lidhje me pranimin për shqyrtim të kundërpadisë dhe bashkimin e saj në gjykim me padinë;<sup>13</sup> nenin 106 të K.Pr.Civile, lidhur me shpenzimet gjyqësore, nenet 443 dhe 444 të K.Pr.Civile lidhur me afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtari ka referuar dhe cituar, si pjesë e arsyetimit të vendimeve: nenin 400 të K.Pr.Penale në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të drejtpërdrejtë; nenin 406 të K.Pr.Penale lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar, nenin 190 të K.Pr.Penale në lidhje me provat materiale, nenin 389 të K.Pr.Penale mbi disponimin për masat e sigurimit, nenin 393 të K.Pr.Penale, sa i përket disponimit për shpenzimet gjyqësore dhe nenin 415 të K.Pr.Penale në lidhje me afatin e ankimit. Në vendimin me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, gjyqtari identifikon

<sup>10</sup> Vendimi nr. 14, datë 02.09.2014 “Për pezullimin e gjykimit”.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 13, datë 22.06.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 9, datë 15.03.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

<sup>13</sup> Po aty.

dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së arrestit (*neni 252 i K.Pr.Penale*), të vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*neni 228 i K.Pr.Penale*) si dhe faktit që gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori (*neni 244/3 i K.Pr.Penale*).<sup>14</sup>

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke i dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’u japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i*

<sup>14</sup> Vendimi nr.62-2015-1745 (444), datë 12.05.2015

*rivlerësimi {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, dhe në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor shpesh (shih dokumentet 1, 2 e 3). Në shumë raste, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentet 1, 2 e 3)”.*

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:**

(i) *Në vendimet civile*, përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Në funksion të arsytimit ligjor, gjyqtari interpreton nenin 132 të K.Familjes, në lidhje me shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe pas këtij interpretimi, referuar provave të paraqitura nga palët dhe referuar edhe pretendimeve të palës paditëse mbi këto shkaqe, konkludon në pranimin e kërkesëpadisë për zgjidhjen e martesës ligjore. Gjithashtu, gjyqtari interpreton dispozitat materiale në lidhje me zgjidhjen e pasojave ligjore që rrjedhin nga mbarimi i martesës, siç është ajo e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe detyrimi për ushqim, të cilat janë pasoja ligjore që nuk lidhen me kërkimet e palëve.<sup>15</sup>
- Referuar interpretimit sistematik që i bën dispozitave materiale (*neneve 12 dhe 21 të K.Punës*), në lidhje me elementët substancialë të kontratës së punës, gjyqtari konkludon se kontrata e punës nuk konsiderohet e zgjidhur me ndryshimin e pozicionit të punës së paditësit dhe uljen në detyrë të tij, dhe për rrjedhojë fakti i paligjshëm, i pretenduar nga paditësi, mbi të cilin ai bazon shkakun ligjor të padisë, nuk ekziston, pra paditësi ka zgjedhur një shkak ligjor të gabuar. Në lidhje me kërkimin tjetër për pagimin e pagave të papaguara, gjyqtari ndalet tek interpretimi literal i dispozitës (*nenit 116 të K.Punës*) duke përcaktuar se për sa kohë një kontratë punë është në fuqi, paga mbetet e paprekshme dhe mosdhënia e pagës ndaj punëmarrësit është në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës;<sup>16</sup>
- Gjyqtari interpreton në mënyrë literale nenin 296 të K.Civil (*padinë e rivendikimit*), në drejtim të përcaktimit të fakteve juridike që kërkohet të provohen në rastin e padisë së

<sup>15</sup> Vendimi Nr.62-2016-522 (134), datë 03.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>16</sup> Vendimi Nr.62-2016-651 (267), datë 24.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.



kërkimit të sendit, si ekzistenca e të drejtës subjektive të pronës së paditësit dhe posedimi i paligjshëm i të paditurit;<sup>17</sup>

- Në vendimin e pezullimit të gjykimit dhe ushtrimin e kontrollit incidental nga Gjykata Kushtetuese, me qëllim zgjidhjen e çështjes në themel, gjyqtari ka interpretuar në mënyrë abstrakte dispozitën relevante të zbatueshme, nenin 168 të K.Civil, nën vështrimin historik me legjislacionin civil të mëparshëm (*nenin 2037 të Kodi Civil i vitit 1929 dhe neni 91 të K.Civil të vitit 1981*) dhe nën vështrimin krahasues, me legjislacionet e vendeve të Bashkimit Europian (*nenin 1159 të K.Civil Italian, nenin 2265 të K.Civil Francez dhe nenin 937 të K.Civil Gjerman*). Gjyqtari analizon dispozitat kushtetuese (*nenet 4, 11, 18 dhe 41 të Kushtetutës*), dhe pas interpretimit abstrakt, arrin në konkluzionin se në çështjen në shqyrtim, ligji është i plotë, i qartë dhe nuk ka asnjë kundërthënie dhe gjykata nuk është përpara pamundësisë për marrjen e një vendimi, por pikërisht kjo vendimmarrje e gjykatës do të ishte antikushtetuese. Gjyqtari konstaton se neni 168/1 i K.Civil, në mënyrën se si është hartuar, cenon një nga të drejtat më themelore, siç është e drejta e pronësisë. Nga ana tjetër, ky cenim vjen për shkak të shkeljes së parimit kushtetues të barazisë së shtetasve përpara ligjit;<sup>18</sup>
- Në vendimin e pezullimit të gjykimit dhe ushtrimin e kontrollit incidental nga Gjykata Kushtetuese, qëllim zgjidhjen e çështjes në themel, gjyqtari ka interpretuar në mënyrë abstrakte dispozitën relevante të zbatueshme, nenin 610 të K.Pr.Civile (*me ndryshimet përkatëse para dhe pas ligjit nr.122/2013*), në përputhje me Kushtetutën (*duke analizuar dhe interpretuar nenin 4, 17, 41, 42 dhe 145/2 të Kushtetutës*), në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Në vijim, pasi gjyqtari ka bërë një interpretim abstrakt të dispozitave kushtetuese, në lidhje me çështjen e procedurës së miratimit të ligjit nr.122/2013, datë 18.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, Kodi i procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”, konkludon se ligji është miratuar në kundërshtim me standardet e procesit të rregullt ligjor legjislativ dhe për rrjedhojë, fjalia e dytë e paragrafit të pestë të nenit 610 të K.Pr.Civile, duhet të shfuqizohet si antikushtetuese, etj.<sup>19</sup>

*(ii) Në vendimin penal:* Gjyqtari referon, citon dhe interpreton nenin 291 të Kodit Penal në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në funksion të analizës së dispozitës materiale (*neni 291*), duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtari referon dhe interpreton nenet 52 dhe 115 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këtë vendim interpretohen gjithashtu dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sa i përket përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, si dhe aplikimit të masave alternative të dënimit me burgim.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale, evidentohet se gjyqtari i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

---

<sup>17</sup> Vendimi Nr.62-2015-4981 (267), datë 24.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>18</sup> Vendimi nr. 9, datë 15.03.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

<sup>19</sup> Vendimi nr. 14, datë 02.09.2016 “Për pezullimin e gjykimit”.

Në vendimet penale interpreton nenin 403 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimin nr.2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; interpreton nenin 190 të K.Pr.Penale në lidhje me provat materiale, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimin nr.00-2013-515 (57), datë 18.02.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet nr. 641, datë 13.06.2012, nr. 280, datë 16.03.2012 dhe nr. 915, datë 28.09.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në vendimin civil me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv, gjyqtari interpreton nenin 510 të K.Pr.Civile në lidhje me përcaktimin e saktë se çfarë do të kuptohet me titull ekzekutiv, si dhe kushtet e vlefshmërisë së tij, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimin nr.6, datë 10.01.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, gjyqtari interpreton nenin 511 të K.Pr.Civile lidhur me momentet që duhen të verifikohen nga gjykata për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, nëse akti është konsideruar nga ligji si titull ekzekutiv dhe nëse ai plotëson ose jo kushtet e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv.<sup>20</sup> Në të gjitha vendimet civile të analizuara, gjyqtari interpreton nenet 443 dhe 444 të K.Pr.Civile, lidhur me afatin e ankimit dhe momentin e fillimit të tij, duke u shoqëruar ky interpretim edhe me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimin nr.2, datë 27.03.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës**

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste, edhe aspekte të veçanta të këtij parimi të tilla si: parimi i sigurisë juridike, parimi i barazisë së shtetasve para ligjit, parimi se mosnjohja e ligjit nuk justifikon kryerjen e një veprimi në kundërshtim me të (*ignorantia legis non excusat*), parimin e proporcionalitetit, etj.

**- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.**

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil apo Penal të Gjykatës së Lartë, dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Rezulton se nga ana e gjyqtarit është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr.2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- Gjyqtari, në funksion të analizës për kthimin e sendit të sekuestruar pronarit të saj, referon në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe të Gjykatës së

---

<sup>20</sup> Vendimi nr. 62-2016-2572 (669), datë 01.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

Apelit Tiranë;<sup>21</sup>

- Në vendimet për ushtrimin e kontrollit incidental nga Gjykata Kushtetuese,<sup>22</sup> në pjesën e arsytimit rezultojnë në mënyrë eksplicite referimi ose analiza në jurisprudencën relevante vendase Kushtetuese dhe Unifikuese të Gjykatës së Lartë (*Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 14.04.2010; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 75/2020, 76/2002, 17/2002; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.39, datë 16.10.2007; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 16.02.2015; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 12.02.2010; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 12.11.2008; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 18.06.2010; Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 06.10.2011, etj.*) ose jurisprudencën ndërkombëtare (*vendimin e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës W Va. Bd. Of Educ. V. Barnette, 319 U.S 624, 638, 1943; vendimin e Gjykatës Supreme të Kanadasë Non charter case of the secession of Quebec, 1998; Vendimet e GJEDNJ - Çështja “Inze kundër Austrisë”, Çështja “Gaygusuz kundër Austrisë”, Çështja “Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerë kundër Irlandës”, Çështja “Chassagnou dhe të tjerë kundër Francës”, Çështja “Stec kundër Mbretërisë së Bashkuar”, etj.*).

## KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## 1.B. ARSYETIMI LIGJOR

### 1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);

<sup>21</sup> Vendimi nr. 62-2014-2783 (464), datë 22.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

<sup>22</sup> Vendimet nr. 9, datë 15.03.2016, nr. 14, datë 02.09.2014 dhe nr. 13, datë 22.06.2016

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruesese.

Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip, në mënyrë të veçantë konstatohet se në të gjitha vendimet gjyqësore përdoren shkronjat shqipe (ë dhe ç). Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtari përdor shpesh termat latinë, por duke sqaruar paraprakisht në çdo rast kuptimin e tyre.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezulton të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2 e 3) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dosjet 4 e 5)*”.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrë e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*) CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konkretisht në mënyrë më specifike konstatohet në çështjet penale se: vendimi gjyqësor përmban të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale, pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenin përkatës të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkruese-arsyetuese* është e ndarë në disa nën-pjesë, në të cilat në mënyrë të detajuar analizon (i) Rrethanat procedurale - në të cilën gjyqtari shkurtimisht ndalet në disa rrethana procedurale në lidhje me kërkesën për të proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë apo për të proceduar me gjykim të shkurtuar, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) Rrethanat e fakteve të çështjes - në të cilën gjyqtari e përshkruan faktet e çështjes të integruara me provat e administruara gjatë gjykimit. Në një rast, mënyra e përshkrimit të rrethanave të çështjes nuk rezulton që të jetë si një fakt i nxjerrë/formuar nga përmbajtja e provave në mënyrë të integruar, por duke cituar në mënyrë eksplicite përmbajtjen e provës përkatëse (*si deklaratimet e personave që kanë dijeni për veprën penale*).<sup>23</sup> (iii) Vlerësimi i gjykatës - në të cilën gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjyqtarit në lidhje me dënimin apo caktimin e masës së sigurimit, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve dhe uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, kur është aplikuar, disponimin për provat materiale, shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit. Në një rast, evidentohet se gjyqtari nuk rezulton të ketë disponuar lidhur me kohën e fillimit të llogaritjes së dënimit, si dhe institucionin e vuajtjes së këtij dënimi.

Në çështjet civile në mënyrë specifike konstatohet se vendimi gjyqësor përmban: pjesën hyrëse, përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkruese-arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë (jo të përcaktuara me tituj, por të nënkuptuara referuar përmbajtjes së tyre) në të cilët gjyqtari analizon: (i) Rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. (ii) Paraqitja në mënyrë të përmbledhur të pretendimeve të palëve. (iii) Vlerësimi i gjykatës, në të cilën, gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me paraqitjen e konkluzionit të gjykatës, lidhur me pranimin apo rrëzimin e padisë.

*Në pjesën e dispozitivit*, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me pranimin/rrëzimin e padisë, përcaktimin e detyrimeve të palës së paditur, në rastet kur

---

<sup>23</sup> Vendimi nr. 1828 (283), datë 20.04.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

padia është pranuar tërësisht ose pjesërisht, disponimi për shpenzimet gjyqësore dhe të drejtën e ankimit. Konstatohet se në vendimet civile që përmbajnë detyrime,<sup>24</sup> gjyqtari nuk rezultojnë të ketë nxjerrë vendim për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, në referim të parashikimeve të nenit 511/1 të K.Pr.Civile.<sup>25</sup>

Gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, kjo sikundër u cituan edhe më sipër sipas pjesëve të vendimit ku gjyqtari ku gjyqtari zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe konkluzionin e arritur.

Nën-ndarja me tituj të vendimit gjyqësor (*rrethana fakti, pretendime, arsyetim e vlerësimi i gjykatës*) nuk janë të vetmet mjete të mjaftueshme për organizimin e argumentimit logjik. Por edhe paragrafët janë ata që organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë atë në njësi më të thjeshta, secila me një fjali tematike kryesore. Vendimet burim vlerësimi janë të strukturuar në paragrafë, me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjyqtarit për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuar, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### 1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar

<sup>24</sup> Vendimi nr. 62-2015-651 (267), datë 24.02.2015; vendimi nr.62-2015-213 (81), datë 22.01.2015; vendimi nr. 62-2016-522 (134), datë 03.02.2016 dhe vendimi nr. 62-2014-1191 (471) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>25</sup> Në nenin 511/1 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve me ligjet nr. nr. 114/2016, datë 3.11.2016; nr. 38/2017, 30.3.2017, parashikohej se: “Për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, urdhri i ekzekutimit lëshohet së bashku me vendimin gjyqësor dhe bëhet i ekzekutueshëm nga përbaruesi gjyqësor vetëm pas konfirmimit nga kancelari. Kancelari konfirmon urdhrin e ekzekutimit vetëm pasi verifikon se vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë”.

vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve gjyqtari i kushton gjithmonë rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentet 1, 2 e 3). Një tipar i mirë i punës së tij është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Por në një rast, në dosjen 3, me objekt zgjidhje martese, u konstatua se në dispozitiv nuk është disponuar lidhur me detyrimin ushqimor për fëmijën dhe të drejtën e takimit të të paditurit me fëmijën, në kundërshtim me kërkesat e nenit 161 të Kodit të Familjes. Niveli i arsyetimit të vendimeve e ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nga 5 dosjet e vëzhguara, në asnjë rast nuk është cenuar vendim nga Gjykata e Apelit e as për shkak të procesit të parregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se gjithmonë disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët. Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi dhe gjithmonë kane referuar edhe bazën ligjore”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Evidentohet kujdesi i gjyqtarit në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari përgjithësisht evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt



gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo penale, gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjet penale.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”**

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

## **2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

### 2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...}, në 4 raste ka qenë brenda afateve standard apo ligjore, por në një rast jashtë këtyre afateve dhe në intervale kohore nga 2 ditë (shih dosjen 5) deri në 1 vit 15 ditë (shih dosjen 2). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje civile, me objekt detyrimin për njohjen pronar, e shqyrtuar në 18 seanca, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimi pjesërisht, vendim i cili është ankimuar nga palët ndërgjyqëse dhe është lënë në fuqi nga apeli (shih dosjen 2)”*.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimit të administruar për shkak të ankesave, dhe çështjes së verifikuar në relacionin e datës 17.03.2014 të KLD, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur këto vendime nuk janë vendime përfundimtare, por janë vendime mbi pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese për kontroll incidental të normës. Çështja e verifikuar në relacionin e datës 17.03.2014, i përket vendimit nr. 3887 (1734), datë 13.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me palë kërkuese Sokol Aliaj, me objekt sigurim padie. Vendimi mban datën 13.11.2013 dhe si të tillë, bën pjesë në periudhën e vlerësimit tetor 2013-tetor 2016 dhe për pasojë, përbën burim vlerësimi. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Nr. 3433, datë 06.12.2021, ku gjyqtari {...} në cilësinë e paditësit ka paditur Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke kërkuar konstatimin e paligjshmërisë së disa veprimeve administrative dhe mosmarrjen parasysh të tyre në vlerësimin e gjyqtarit, përveç faktit që nuk ka marrë formë të prerë, nuk rezulton të jetë shprehur lidhur me burimet e vlerësimit në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën vlerësimit 2013-2016.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe çështjes të verifikuar dhe analizuar në relacionin e KLD, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht:

- (i) Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (*vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 24 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Referuar dosjes që i përket vendimit nr. 62-2015-1745 (444), datë 12.05.2015, rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit, është regjistruar në gjykatë në datën 10.05.2015, ora 14:00 dhe ka përfunduar në datën 12.05.2015, ora 11:15 duke përfunduar brenda afatit ligjor prej 48 orësh, të parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale.
- (ii) Çështja e kategorisë kërkesë civile pa palë kundërshtare (*sigurim padie*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 5 ditor nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 202 të K.Pr.Civile. Referuar vendimit nr.3887 (1734), datë 13.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Fier, rezulton se kërkesa për sigurimin e padisë, është regjistruar në datën 05.11.2013, duke përfunduar për 8 ditë, pra jashtë afatit ligjor prej 5 ditësh, të parashikuar në nenin 202 i K.Pr.Civile.

Nëse në vlerësimin e këtij treguesi do të përfshiheshin edhe tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, do të rezultonte se për çështjen me nr. 21274-01246-62-2014 (1240) regjistri, datë regjistrimi 12.06.2014, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, për të cilën parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 20 ditor i përcaktuar në nenin 610 të K.Pr.Civile. Referuar vendimit mbi pezullimin e gjykimit, me nr. 14, datë 02.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjqësor Fier, rezulton se çështja për kundërshtim të veprimeve përmbarimore dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore është regjistruar në datën 12.06.2014 dhe deri në datën 02.09.2014 kur është dhënë vendimi i pezullimit nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga gjykata, duke tejkaluar deri në atë moment me 62 ditë afatin ligjor.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në të cilën përcaktohet se vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor, dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna se kur ka përfunduar gjykimi i kësaj çështjeje të përzgjedhur nga gjyqtari, vlerësimi do të bëhet duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, ku rezulton se për 2 (dy) çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre, në 1 (një) prej tyre rezulton që gjyqtari të ketë shkelur afatin ligjor për përfundimin e saj, e shprehur në përqindje 50% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 50% përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë. Megjithatë, përveç analizës matematike, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar të dhënave burim vlerësimi, rezulton se tejkallimi i afatit ligjor në çështjen e gjykuar jashtë afatit ka ardhur për shkaqe procedurale. Konkretisht, çështja i është caktuar me short gjyqtarit në datën 05.11.2013 dhe seanca është caktuar në

datën 11.11.2013, pra dosja është vënë në lëvizje dhe është zhvilluar seanca brenda afatit 5 ditor. Në seancën e datës 11.11.2013 është legjitimuar edhe një ndërhyrës, i cili ka depozituar prapësime dhe prova me shkrim. Në kushtet kur vendimi për shtyrjen e seancës është marrë për shpalljen e vendimit nga gjyqtari, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, me qëllim shqyrtimin e provave dhe prapësimeve të depozituara në seancë, këto veprime procedurale kanë ndikuar në tejkalimin e afatit ligjor.

#### **KONKLUSIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuarra për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre, me përjashtim të një çështjeje, e cila ka zgjatur tej afatit ligjor, por për shkaqe procedurale. Referuar edhe metodologjisë së pikëzimit, ku përcaktohet se të dhënat analizohen sipas situatës, me qëllim shmangien e përfundimeve që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, gjyqtari {...} lidhur me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” vlerësohet në nivelin “0-10%”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, duke pasur parasysh edhe shkaqet që kanë ndikuar në këtë tregues, gjyqtari vlerësohet në nivelin “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...}, në 4 raste ka qenë brenda afateve standard apo ligjore, por në një rast jashtë këtyre afateve dhe në intervale kohore nga 2 ditë (shih dosjen 5) deri në 1 vit 15 ditë (shih dosjen 2). çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje civile, me objekt detyrimin për njohjen pronar, e shqyrtuar në 18 seanca, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimi pjesërisht, vendim i cili është ankimuar nga palët ndërgjyqëse dhe është lënë në fuqi nga apeli (shih dosjen 2). Në tre dosjet e tjera,

*kohëzgjatja e gjykimit ka qene 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 4), 2 muaj e 18 ditë (shih dosjen 3) dhe 3 muaj e 20 ditë (shih dosjen 1). Në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit, rezulton se ato janë vendime pezullimi e jo përfundimtare dhe kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë civile është 2 muaj e 20 ditë (shih dokumentin 1), për çështjen e dytë civile është 1 vit 1 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 2) dhe për çështjen e tretë civile është 1 vit 4 muaj e 25 dite (shih dokumentin 3). Për çështjen e dyte dhe të tretë civile, rezulton se është tejkaluar afati 6 mujor i caktuar nga pika 5 shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, duke shtuar këtu faktin se çështjet nuk ishin përfunduar ende me vendim përfundimtar. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj tij janë e paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD së, 3 prej të cilave janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndërsa një ankese është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar gjyqtarit {...} për efekt vlerësimi etik e profesional”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10<sup>26</sup> çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave, pa përfshirë tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur këto vendime nuk janë vendime përfundimtare, por janë vendime mbi pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese për kontroll incidental të normës.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur tej standardeve minimale kohore për shumicën e çështjeve, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

#### Çështje penale të kategorisë krime:

- Dosja 4 - (është caktuar për gjykim në datën 09.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.07.2014) Gjykimi ka zgjatur 43 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 11 - (është caktuar me short në datën 22.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 20.04.2016) Gjykimi ka zgjatur 180 ditë, brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

#### Çështje civile:

---

<sup>26</sup> Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim, konkretisht vendimi nr.62-2015-1745 (444), datë 12.05.2015

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 24.12.2013 dhe ka përfunduar në datën 14.04.2014) Gjykimi ka zgjatur 111 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 28.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 13.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 381 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 15.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 252 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 02.10.2014 dhe ka përfunduar në datën 24.02.2015) Gjykimi ka zgjatur 145 ditë, brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Në çështjen civile nr.21282-01106-62-2015 (1530/172) regjistri, të administruar për shkak të ankesave, sipas të dhënave në vendim nr. 62-2016-2572 (689), rezulton se data e regjistrimit është 16.06.2015 dhe data e përfundimit të çështjes 01.06.2016. Çështja ka përfunduar për 350 ditë, tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

#### Çështje familjare:

- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 19.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 07.04.2016) Gjykimi ka zgjatur 78 ditë, brenda afatit 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 29.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 03.02.2016) Gjykimi ka zgjatur 127 ditë, tej afatit 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare.

#### Çështje administrative:

- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 02.10.2013 dhe ka përfunduar në datën 10.12.2013) Gjykimi ka zgjatur 69 ditë, tej afatit 30 ditor të standardit minimal kohor për gjykimet administrative;
- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 04.04.2013 dhe ka përfunduar në datën 14.10.2013) Gjykimi ka zgjatur 193 ditë, tej afatit 30 ditor të standardit minimal kohor për gjykimet administrative.

Nëse në vlerësimin e këtij treguesi do të përfshiheshin edhe tre vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, do të rezultonte se për çështjen civile me nr. 11125-00162-62-2015 (740/189) regjistri, datë regjistrimi 27.01.2015, me objekt “Lirim, dorëzim sendi dhe njohje pronar”, deri në datën e vendimit mbi pezullimin e gjykimit, me nr. 9, datë 15.03.2016 kanë kaluar 1 vit e 1 muaj 16 ditë, pra dukshëm tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile; për çështjen civile me nr. 11118-02270-62-2015 (1998/151) regjistri, datë regjistrimi 27.01.2015, me objekt “Shpërblim dëmi real, pasuror dhe jopasuror”, deri në datën e vendimit mbi pezullimin e gjykimit, me nr. 13, datë 22.06.2016 kanë kaluar 1 vit e 4 muaj 25 ditë, pra dukshëm tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në të cilën përcaktohet se vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor, dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna se kur ka përfunduar gjykimi i këtyre dy çështjeve të përzgjedhura nga gjyqtari, vlerësimi do të bëhet referuar 11 çështjeve për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër referohet më sipër, ku 6 prej tyre kanë përfunduar tej standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Pra, në total, 55% të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Përqindja matematikore prej 55% përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë, por vlerësuesi, veç analizës matematikore, duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Pavarësisht se për 55% të çështjeve të shqyrtuara, rezulton tejkallimi i standardit minimal kohor të pranuar, rezulton se kjo përgjithësisht nuk është pasojë e mosmenaxhimit efektiv të procesit, por pasojë e ecurisë procedurale të çështjes, kërkesave të palëve dhe moszhvillimit të disa seancave të planifikuara për shkak të njoftimit të palëve, etj. Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtari ka përfunduar në total gjatë të gjithë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit 1375 çështje, nga të cilat 560 çështje<sup>27</sup> kanë qenë çështje me palë kundërshtarë, mesatarisht 187 çështje themeli në vit,<sup>28</sup> pra 56% më shumë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, për gjyqtarin e shkallës së parë të dhomës civile, seksioni i përgjithshëm.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara, që rezultojnë në masën 55%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat, nga dosjet e vëzhguara, përgjithësisht, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) standardi sasior i punës i cili është më i lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, gjyqtari për këtë tregues vlerësohet një nivel më lart se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, kjo në kushtet kur standardi sasior i punës është 56% më shumë se ngarkesa minimale e përcaktuar.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardevë minimale kohore” aftësia e gjyqtarit vlerësohet “30-40 %”, duke e pikëzuar me 2 pikë.*

## **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

<sup>27</sup> 416 civile me palë kundërshtarë, 124 familjare dhe 20 çështje penale.

<sup>28</sup> Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit të përgjithshëm, jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtarë.

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...}, në 4 raste ka qenë brenda afateve standard apo ligjore, por në një rast jashtë këtyre afateve dhe në intervale kohore nga 2 ditë (shih dosjen 5) deri në 1 vit 15 ditë (shih dosjen 2). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje civile, me objekt detyrimin për njohjen pronar, e shqyrtuar në 18 seanca, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimi pjesërisht, vendim i cili është ankimuar nga palët ndërgjyqëse dhe është lënë në fuqi nga apeli (shih dosjen 2). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 4), 2 muaj e 18 ditë (shih dosjen 3) dhe 3 muaj e 20 ditë (shih dosjen 1). Në 4 nga 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit, rezulton se ato janë vendime pezullimi e jo përfundimtare dhe kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë civile është 2 muaj e 20 ditë (shih dokumentin 1), për çështjen e dytë civile është 1 vit 1 muaj e 16 ditë (shih dokumentin 2) dhe për çështjen e tretë civile është 1 vit 4 muaj e 25 ditë (shih dokumentin 3). Për çështjen e dytë dhe të tretë civile, rezulton se është tejkaluar afati 6 mujor i caktuar nga pika 5 shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, duke shtuar këtu faktin se çështjet nuk ishin përfunduar ende me vendim përfundimtar. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj tij janë e paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD së, 3 prej të cilave janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndërsa një ankese është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar gjyqtarit {...} për efekt vlerësimi etik e profesional”.*

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short (pa përfshirë vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, në kushtet kur nuk janë vendime përfundimtare), si dhe çështjen e administruar për shkak të ankesave, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.<sup>29</sup>

<sup>29</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.*



Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 11 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 2 çështje familjare, 2 çështje penale themeli, 5 çështje civile themeli dhe 2 çështje administrative), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare”, rezulton të jetë 103 ditë, rreth 3 muaj e 13 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare.<sup>30</sup>
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 112 ditë ose 3 muaj e 22 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale “krime” në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>31</sup>
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 5 (pesë) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë 248 ditë, rreth 8 muaj e 8 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>32</sup>
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Administrative”, rezulton të jetë 131 ditë, rreth 4 muaj e 11 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve administrative në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>33</sup>

## KONKLUZIONE

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon më një pikëzim prej 3 pikësh. Mbështetur në të njëjtën analizë si ajo e treguesit të mësipërm (treguesi 2.A.b “Plotësimi i standardeve minimale kohore”), gjyqtari për këtë tregues pikëzohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit, pasi gjyqtari ka tejkuluar standardin minimal kohor në masën 56%.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 4 pikë.

<sup>30</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj”.

<sup>31</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

<sup>32</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.

<sup>33</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “c. Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj”.

## 2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, duke përcaktuar për periudhën tetor 2013-janar 2014 fushën e të drejtës civile dhe nga janari i vitit 2014 e në vazhdim në seksionin penal të kësaj gjykate, pra fushën e të drejtës penale. Ai ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1379 çështje, ka përfunduar gjithsej 1382 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 107 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 100,2%”.*

Në total, në të gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtarit {...} i janë caktuar 1379 çështje dhe ka përfunduar gjykimin për 1375 çështje, nga të cilat 20 çështje penale, 416 çështje civile, 124 çështje familjare, 271 kërkesa në fazën e hetimit paraprak, 536 kërkesa civile dhe 8 kërkesa penale.

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga gjykatat për numrin e çështjeve të caktuara dhe atyre të përfunduara, rezulton se gjyqtarit për gjithë periudhën e vlerësimit i janë caktuar në total 1379 çështje dhe ka përfunduar 1375 prej tyre. Nga rillogaritja e rendimentit sipas këtyre të dhënave, rezulton një normë likuidimi çështjesh prej 99.7%.

### KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 99.7%.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “+99%”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

## 2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, pa patur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej tij pas 2 ditëve (shih dosjen 1), pas 3 ditëve (shih dosjen 5) dhe pas 6 ditëve (shih dosje n 3). Vetëm në një rast u konstatua se gjyqtari e ka dorëzuar dosjen penale jashtë afatit ligjor 5 ditor, pas 7 ditëve (shih dosjen 4). Se fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtari {...} ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka patur ngarkesë sasiore nën standardin minimal, por jo gjithmonë i ka kushtuar rëndësi gjykimit dhe arsyetimit të shpejte të vendimeve gjyqësore”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit.

Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

- Dosja 1, që i përket vendimit civil me nr. 62-2014-1191 (471), datë 14.04.2014, është dorëzuar në datën 16.04.2014 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 2, që i përket vendimit civil me nr.62-2015-4981 (1480), datë 13.11.2015 është dorëzuar në datën 20.11.2015 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 3, që i përket vendimit civil me nr. 1569 (410), datë 07.04.2016 është dorëzuar në datën 13.04.2016 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 4, që i përket vendimit penal me nr. 62-2014-2783 (464), datë 22.07.2014 është dorëzuar në datën 29.07.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit

415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;

- Dosja 5, që i përket vendimit penal me nr. 62-2015-1745 (444), datë 12.05.2015 është dorëzuar në datën 15.05.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier,<sup>34</sup> lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 26.01.2022, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit civil me nr. 62-2013-4231 (1852), datë 10.12.2013 është dorëzuar në datën 16.12.2013 - (6 ditë), tej afatit të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile, pasi është shtyrë për shpallje të arsyetuar të vendimit;
- Dosja 7, që i përket vendimit civil me nr.3467 (1596), datë 14.10.2013 është dorëzuar në datën 21.10.2013 - (7 ditë), tej afatit të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile, pasi është shtyrë për shpallje të arsyetuar të vendimit;
- Dosja 8, që i përket vendimit civil me nr.62-2015-213(81), datë 22.01.2015 është dorëzuar në datën 30.01.2015 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 9, që i përket vendimit civil me nr.62-2015-651 (267), datë 24.02.2015 është dorëzuar në datën 06.03.2015 - (10 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 10, që i përket vendimit civil me nr.62-2016-522 (134), datë 03.02.2016 është dorëzuar në datën 08.02.2016 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- Dosja 11, që i përket vendimit penal me nr.1828 (283), datë 20.04.2016 është dorëzuar në datën 25.04.2016 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se për çështje të kategorisë “*Civile themeli*”, koha mesatare e arsyetimit është 6.3 ditë, për çështje të kategorisë “*Penale krime*”, koha mesatare e arsyetimit është 5 ditë.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

---

<sup>34</sup> Shkresa nr. 559 Prot., datë 01.02.2022, protokolluar në Këshill me aktin nr. 687 Prot., datë 02.02.2022.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në tre çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 7, 18 e 3 seanca. Ndërsa në 2 çështjet penale të vëzhguara, një prej të cilave lidhet me vepër penale krim, ka përfunduar me 4 seanca dhe çështja tjetër administrativo-penale, vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi, është përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 4 e 5). Rezulton se në dosjen e katërt, penale, seancat gjyqësore janë shtyrë duke respektuar afatin 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale. Konkretisht janë vëzhguar gjithsej 33 seanca gjyqësore, nga të cilat 26 kanë qenë produktive. Pengesë në 7 seanca joproductive kanë qenë: kërkesa për shtyrje e palës paditëse (2 seanca), mosparaqitja e ekspertit (2 seanca), kërkesa për shtyrje e palës së paditur (1 seancë), mosformimi i trupit gjykues, për mosparaqitje të vetë gjyqtarit (1 seancë) dhe mosparaqitja e prokurorit (1 seancë)”.

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, 10 (dhjetë) çështje vlerësohen si çështje me palë kundërshtare, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 1 – që i përket çështjes civile me nr. 11211-03071-62-2013 (2395/198) regjistri, datë regjistrimi 24.12.2013, me objekt “Detyrimin për pagimin e çmimit të shitjes së mallrave dhe kamatëvonesave”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2014-1191

(471), datë 14.04.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nuk ka patur seanca joproductive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për t'u njohur me aktin e ekspertimit, apo lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 2 – që i përket çështjes civile me nr. 21246-02288-62-2014 (1894/273) regjistri, datë regjistrimi 28.10.2014, me objekt “Detyrimi njohje pronar”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2015-4981 (1480), datë 13.11.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 15 (pesëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 6 (gjashtë) seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të moskryerjes së pagesës së ekspertimit nga palët, mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës së paditur, mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës paditëse dhe mosformimit të trupit gjykues. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e ekspertëve të caktuar nga gjykata, lënien kohë ekspertëve për të përgatitur aktet e ekspertimit, lënien kohë palëve për t'u njohur me aktet e ekspertimit, për t'u shprehur gjykata lidhur me kërkesën për pezullimin e gjykimit, lënien kohë palës paditëse për të përgatitur me shkrim kërkesën për shtimin e objektit të padisë, apo lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 3 –që i përket çështjes familjare me nr. 21001-00079-62-2016 (661) regjistri, datë regjistrimi 15.01.2016, me objekt “Zgjidhje martese dhe lënien e fëmijës për rritje dhe edukim”, ka përfunduar me vendimin nr.1569 (410), datë 07.04.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive. Seanca është shtyrë për shkaqe procedurale, konkretisht: lënien kohë ekspertes psikologe për të përgatitur aktin e vlerësimit psikologjik.

➤ Dosja 4 –që i përket çështjes penale me nr.58345-00955-62-2014 95170 regjistri, datë regjistrimi 09.06.2014, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr. 62-2014-2783 (464), datë 22.07.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproductive dhe është shtyrë për mosparaqitjen e prokurorit. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë prokurorit dhe mbrojtësit të të pandehurit për të përgatitur konkluzionet përfundimtare me shkrim.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

➤ Dosja 6 – që i përket çështjes administrative me nr.31018-02405-62-2013 (2000) regjistri, datë regjistrimi 02.10.2013, me objekt “Ndryshimin e vendimit të Drejtorisë së Lejeve të Drejtimit dhe shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Shkallës së Parë të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier, për refuzimin për t'u pajisur me leje drejtimi”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2013-4231 (1852), datë 10.12.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar

joproductive, për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, apo shpalljen e arsyetuar të vendimit.

➤ Dosja 7 – që i përket çështjes administrative me nr.31010-01014 (1083) regjistri, datë regjistrimi 04.04.2012, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të Degës Doganore Fier për pagimin e detyrimit të akcizës dhe anulimin e gjobës”, ka përfunduar me vendimin nr.3467 (1596), datë 14.10.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 9 (nëntë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 (katër) seanca kanë rezultuar joproductive, për shkak të mosparaqitjes së palës së paditur, mosrealizimit të njoftimit për palën e paditur dhe mosformimit të trupit gjykues. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë palës së paditur për të përgatitur me shkrim prapësimet e saj, në kushtet kur pala paditëse ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai mbajtur në seancë përgatitore, duke hequr dorë nga një pjesë e kërtimeve të saj, lënien kohë palëve për të paraqitur prova në formën e kërkuar nga ligji, lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim, apo shpalljen e arsyetuar të vendimit.

➤ Dosja 8 – që i përket çështjes civile me nr. 21235-00963-62-2014 (1078/267) regjistri, datë regjistrimi 15.05.2014, me objekt “Përmbushje e detyrimit kontraktor”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2015-213 (81), datë 22.01.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproductive, për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata, lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për t’u njohur me aktin e ekspertimit, apo lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 9 – që i përket çështjes civile me nr. 21264-02071-62-2014 (1745/287) regjistri, datë regjistrimi 02.10.2014, me objekt “Padi marrëdhënie pune”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2015-651 (267), datë 24.02.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: lënien kohë palës paditëse për të paraqitur prova të reja, marrjen e provës pranë palës së paditur, apo lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.

➤ Dosja 10 – që i përket çështjes familjare me nr. 21001-02169-62-2015 (1945/179) regjistri, datë regjistrimi 28.09.2015, me objekt “Zgjidhje martesë”, ka përfunduar me vendimin nr.62-2016-522 (134), datë 03.02.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive. Seanca është shtyrë për shkaqe procedurale, konkretisht: lënien kohë ekspertes psikologe për të përgatitur aktin e vlerësimit psikologjik.

➤ Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.53101-02514-62-2015 regjistri, datë regjistrimi 21.10.2015, gjykimi i të pandehurit për veprën penale “Vjedhja” më shumë se një herë, në rrethana rënduese, e parashikuar nga nenet 134/2 dhe 50/ç të K.Penal, ka përfunduar me vendimin nr.1828 (283), datë 20.04.2016, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproductive.

Nga tërësia e të dhënave siç parashtrihen më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare, varion nga 1, deri në 15 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 5.5 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (*çështje civile themeli dhe penale themeli*) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile, nenin 333 e vijues dhe 342 të K.Pr.Penale, nenin 132 të Kodit të Familjes*). Përgjithësisht, gjyqtari ka mbikëqyrur siç duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Thuhet “përgjithësisht” pasi në disa raste konstatohet se mungesa e njoftimeve për palët është bërë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: dhënien kohë palëve për të paraqitur prova, për përgatitjen e aktin të ekspertimit, për të përgatitur prapësimet, për të përgatitur diskutimin përfundimtar me shkrim, për shpalljen e vendimit të arsyetuar etj. Në përgjithësi, në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, ndërsa në çështjet civile, pavarësisht se nuk rezulton të jetë parashikuar në ligjin procedural të kohës një afat për shtyrjen e seancave gjyqësore, ato në çdo rast janë planifikuar brenda afateve të arsyeshme, me përjashtim të rasteve kur seancat janë planifikuar mbi një muaj, për shkak të pushimeve vjetore në muajin gusht, apo në muajin dhjetor, kur administrata gjyqësore kryen procedurën e mbartjes së dosjeve.

Bazuar në sa parashtrihet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 5.5, por rezulton gjithashtu se gjyqtari ka treguar kujdes, duke marrë përgjithësisht të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.



*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.*

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në tre çështje civile të vëzhguara, ai ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 1, 2 e 3). Në këto tre raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale....Gjatë gjykimit, ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi provave, diskutimi përfundimtar e gjer tek shpallja e vendimit”.

- *Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre u përkasin kategorive të çështjeve penale, civile, familjare dhe administrative me palë kundërshtare dhe 1 (një) çështje i përket kategorisë së kërkesave penale në fazën e hetimit paraprak.

Gjyqtari në çdo rast i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, në çdo rast, duke filluar nga brenda ditës, deri në 5 ditë pas caktimit të çështjes me short. Në çështjen penale është respektuar afati procedural 10 ditor, i parashikuar në nenin 333/1 të Kodit të Procedurës Penale. Seancat përgatitore të zhvilluara në çështjet e

vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës të mbajtur nga sekretarja gjyqësore, ndërsa seancat gjyqësore rezultojnë të jenë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit të seancave audio (*jo të gjitha seancat në çështjet e vëzhguara*), si dhe janë dokumentuar nëpërmjet procesverbalit të seancës të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

*Në çështjet civile:* Përgjithësisht, rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, relativimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijëni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve (në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla), deklarimin të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe të provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat dhe mbi elementët proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

*Në çështjen penale:* Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (është proceduar me gjykim të shkurtuar). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relativimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 14 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës dhe përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe të dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me

korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil dhe penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi : Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shih dosjet 1, 2 e 3) ose penale (shih dosjet 4 e 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezultojnë se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, gjithashtu të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile. Por në një rast, në dosjen 4, u konstatua se në procesverbalin e fundit nuk është pasqyruar dispozitivi i vendimit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 346 të K.Pr.Penale. Megjithatë, rezultojnë se procesverbali gjyqësor dokumenton kohen, vendin dhe veprimet që janë kryer në seancë, gjatë shqyrtimit gjyqësor. Konstatohet se 7 nga 33 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe ë solemnitetit në gjykim. Sa i përket fillimit me vonesë të seancës gjyqësore, rezultoi se nga 33 seanca të vëzhguara gjithsej, në 13 prej tyre është konstatuar vonesë në çeljen e seancës gjyqësore nga 16 minuta deri në 1 orë e 7 minuta, për të cilat në shumicën e rasteve, pasi u dëgjuan edhe regjistrimet në audio të seancave, është pasqyruar dhe dokumentuar shkaku. Në rastin e vonesës me të madhe 1 orë e 7

*minuta, tek seanca gjyqësore e datës 09.03.2015, në dosjen 2, është relatuar si shkak “angazhimi i gjyqtarit në një çështje penale”.*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda të njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet sipas rendit kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e me pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët”*.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

#### **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”**

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	96

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar*

*këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.*

### **3.A. ETIKA NË PUNË**

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin {...} nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, apo të jetë propozuar në ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë mase për procedim disiplinor”.*

#### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1724/5 Prot., datë 06.11.2020, rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2013 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe shkelja i është evidentuar për efekt vlerësimi etik dhe profesional. Në lidhje me këtë ankesë rezulton se:

Shtetasi S.A. ka bërë ankesë pranë KLD në vitin 2013 ndaj veprimtarisë së gjyqtarit {...} për mosrespektim formal të ligjit në lidhje me çështjen civile me palë kërkuese shtetasin S.A., me objekt “Sigurim padie”. Për verifikimin e ankesës është urdhëruar me urdhrin nr. 3445/3 Prot., datë 14.01.2014, kryerja e verifikimeve përkatëse.

Në raportin e Inspektoratit të KLD, lidhur me pretendimet e ankuesit S.A., ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit {...} analizohet se: *“Lidhur me konstatimin, se Gjyqtari {...} nuk ka shqyrtuar brenda afatit 5 ditor, kërkesën e ankuesit S.A. për sigurimin e padisë, rezulton nga aktet e administruara në dosje se nga data 05.11.2013 kur është shortuar kërkesa e deri në datën 13.11.2013 kur është shpallur vendimi, kanë kaluar tetë ditë. Në këto rrethana, ky konstatim është i vërtet dhe qëndron sa i përket afatit të shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit, pasi në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: “Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë...”. Në këtë rast gjykata e ka shqyrtuara këtë kërkesë për një periudhë 8 ditë pas paraqitjes së saj, në shkelje të afatit 5 ditor të përcaktuar në ligj, prandaj ky tejkalim i afatit të shqyrtimit të kërkesës, përbën mosrespektim formal të ligjit nga ana e gjyqtarit {...}. Por, ky tej kalim i afatit 5 ditor të shqyrtimit të kërkesës për sigurimi padie, nga ane gjyqtarit {...}, megjithëse konstatohet shkelje e pajustificuar e dispozitave urdhëruese procedurale civile, nuk çmohet i mjaftueshëm nga ligj si shkelje disiplinore, pasi shkelja disiplinore nuk është thellësisht e tillë që mund të iniciohet përshtatshëm një procedim disiplinor, siç parashikohet në*

germën “c” të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Pasi analizohet situata e faktit dhe e ligjit, në relacion konkludohet se “Tejkalimi i afatit të gjykimit nga gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier {...} në shqyrtimin e kërkesës së S.A. për sigurim padie, të kihet parasysh në Sistemin e Vlerësimit Profesional dhe Etik të tij”.

Me Vendimin nr. 3433 (80-2021-3495), datë 06.12.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë të paditësit {...}. Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ shkresë, datë 17.03.1994 me lëndë “Relatim mbi verifikimin e ankesës së shtetasit S.A.” e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Detyrimin e palës së paditur Këshillit të Lartë Gjyqësor të mos marrë parasysh në vlerësimin e gjyqtarit z. {...}, të çregjistrojë dhe të heqë nga dosja shkresën, datë 17.03.2014, me lëndë “Relatim mbi verifikimin e ankesës së shtetasit S.A.” e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Rrëzimin për pjesën tjetër, si e pabazuar në ligj dhe në prova. Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënie në ekzekutim të vendimit në ngarkim të palëve në masën 1/2 secila. Ky vendim gjyqësor përbën titull ekzekutiv, pasi të marrë formë të prerë dhe duhet të ekzekutohet menjëherë nga përmbartimi gjyqësor. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve, filluar ky afat nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar. Vendimi i arsyetuar t’u komunikohet palëve dhe avokaturës së shtetit”. K vendim nuk ka marrë formë të prerë, për shkak të ushtrimit të të drejtës së ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit, si dhe dosjes personale të gjyqtarit {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj tij.

Në relacionin e hartuar nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit. Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 455, datë 07.10.2021, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”*.

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, vetëm 1 (një) ankesë ndaj gjyqtarit {...} është verifikuar dhe evidentuar për efekt vlerësimi etik dhe profesional. Ankesa është paraqitur në vitin 2013 dhe është referuar e analizuar në treguesin e analizuar më sipër. Në materialet për verifikimin e ankesës rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Për sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin”*.<sup>35</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 455, datë 07.10.2021, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të

---

<sup>35</sup> Faqe 13 e vendimit të KPK nr. 455, datë 07.10.2021.



vlerësimin figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: “Në përfundim, në kuadrin e verifikimit të figurës, Komisioni arrin në konstatimin se nuk ekziston asnjë prej tri rrethanave ligjore, për të cilat mund të shkarkohet subjekti i rivlerësimit. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime të qarta dhe të plota dhe referuar kërkesave të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.<sup>36</sup>

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasoje cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”.

#### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

<sup>36</sup> Faqe 15 e vendimit të KPK nr. 455, datë 07.10.2021.

- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga aktet e çështjeve të përzgjedhura me short rezulton se

në çështjen civile të përfunduar me vendimin nr. 1480, datë 13.11.2015, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është paraqitur nga ana e palës së paditur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesë e cila është rrëzuar nga gjykata. Po në këtë çështje, ndodhet e administruar kërkesa e gjyqtarit {...} për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, e paraqitur në datën 23.10.2015. Kërkesa është shqyrtuar nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili me vendimin e datës 23.10.2015 ka vendosur mospranimin e kërkesës. Nga ana tjetër, nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### **4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

## **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qofte në seancat përgatitore, qofte në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qarte, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara, nuk është konstatuar që palët të kenë paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarit, ndërsa nuk u konstatuan raste dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”*.

### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave (*kryesisht procesverbaleve të seancave, regjistrimet e seancave në sistemin audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim, akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit, apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm për gjykimin e çështjes dhe ka

*bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale”.*

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe në mungesë të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit {...}, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimit të programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 15 trajnime, gjithsej 29 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale. Subjekti i rivlerësimit {...} ka deklaruar se nuk ka marrë pjesë në aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës”.*

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1724/5 Prot., datë 06.11.2020, vërtetimit me nr. 554 Prot., datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.544 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 15 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 29 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 15 aktivitete të zhvilluara për 29 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.



*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lektor dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013–2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari duke të vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

*Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

#### **NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	387	Shkëlqyeshëm

#### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT</b>			
	<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT</b>			
	<b>Tregues</b>	<b>Burimet</b>	
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	31-40 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të</li> </ul>	Më e shkurtër se standardi për

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).	shumicën e kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	+99 %
	Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> <li>▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë

	Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
--	---	--	---------------

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
<b>A. Etika në punë</b>	Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	I pa konsiderueshëm

### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	Shumë e lartë
	Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).</li> </ul>	I lartë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë
	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit.</li> </ul>	Shumë e lartë

<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë		
	Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna		
	Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna		
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna		
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>387</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>Shkëlqy</b>			

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**